



BASHKIA E TIRANËS
KRYETARI
URDHËR

NR. 9065 / datë 24.3 2017

Për

“Organizimin, funksionimin dhe ofrimin e shërbimit këshillimor bujqësor në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë”

Me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave si dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, si dhe në mbështetje të nenit 3, shkronja “ç”, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1\1.1, shkronja “b”, nenit 22, nenit 27, pika 3, nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 30 të Ligjit nr. 9817, datë 22.10.2017 për “Bujqësinë dhe zhvillimin rural”; Memos së Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik me nr.prot.9065, datë 07.03.2017 me lëndë: “Informacion mbi organizimin, funksionimin dhe ofrimin e Shërbimit Këshillimor për bujqësinë dhe objektivat për të ardhmen”.

URDHËROJ:

1. Organizimin, funksionimin dhe ofrimin e shërbimit këshillimor bujqësor në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, sipas platformës së shërbimit këshillimor në aneksin 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për ofrimin e shërbimit këshillimor ngarkohen specialistët e profilit bujqësor të Bashkisë Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik) dhe specialistët e Njësive Administrative sipas përcaktimeve në aneksin 2, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Njësitë Administrative Rurale, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore për njoftimin e këtij urdhri strukturave të përcaktuara në pikën 3.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëhere.

KRYETAR

Erion VELIAJ

